

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	BE vendos kufij për rrjetet sociale: Kush rrezikon të mbetet jashtë? - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/be-vendos-kufij-per-rrjetet-sociale-kush-rrezikon-te-mbetet-jashte/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	26 shtator 2026, 06:25:48 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	26 shtator 2026, 06:10:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	31d113fcbd4ffb91f26db6b1e2597b29908e02fee5218ff07d5556eba409acd7
TEKSTI	518aee3fb018241e9e03912140c2b7334568bb02f210727f8fa3cbe78f6e7beb
PAMJA	625eab502ec58b1599aa87da7aad65446c94b09927d44a9b248133842065d8f6

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	8be6ddaa28cbf8791188bd08c73af1564eff2f8180c0d8e8fc3b9922a46db1ab
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	df7a3e632afe7e8acb9ac556f323199c5ae38613c8b46aabf6598ebdbd0b152a
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërën nga tri gjendjet — **nuk u gjet**, **në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/8be6ddaa28cbf8791188bd08c73af1564eff2f8180c0d8e8fc3b9922a46db1ab>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » BE vendos kufij për rrjetet sociale: Kush rrezikon të mbetet jashtë?

BOTË

Demo

BE vendos kufij për rrjetet sociale: Kush rrezikon të mbetet jashtë?

SEPTEMBER 26, 2026



“Fëmijët meritojnë një internet më të sigurt.” Me këtë mesazh, presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, prezantoi më 17 shtator Aktin e BE-së për Fëmijët (EU Kids Act), një propozim që synon të vendosë kufizime të reja për përdorimin e rrjeteve sociale nga të miturit.

Nisma parashikon kufizime të lidhura me moshën, ndërsa ndalon për personat nën 18 vjeç disa praktika të dizajnuara për të krijuar varësi, mes tyre edhe lëvizjen pa fund në përmbajtje, e njohur si “infinite scroll”. Propozimi kërkon gjithashtu mekanizma për verifikimin e moshës, të ndërtuar në mënyrë që të respektojnë privatesinë e përdoruesve.

Në vend që përdoruesit të detyrohen të paraqesin dokumente identifikimi, si certifikata lindjeje, platformat do të marrin vetëm një përgjigje në formën “po” ose “jo” për të konfirmuar nëse personi plotëson moshën e kërkuar.

Zëvendëspresidentja ekzekutive e Komisionit Evropian, Henna Virkkunen, e ka përshkruar qasjen si një shtyrje të aksesit në platformat me rrezik më të lartë, dhe jo si një ndalim të plotë.

Sipas propozimit, fëmijët do të njiheshin gradualisht me platformat me rrezik më të lartë në moshat 13, 15 dhe 18 vjeç, në vend që të përjashtoheshin menjëherë prej tyre.

Por mënyra se si është konceptuar nisma ka ngritur shqetësime te organizatat që merren me të drejtat digjitale. Sipas Euronews, kritikët argumentojnë se fokusi te moshë mund të mos adresojë shkaqet më të thella të problemeve që lidhen me platformat online.

“Propozimi paraqitet sikur problemi të jetë moshë”, tha Simeon de Brouwer, këshilltar politik në European Digital Rights (EDRI), një rrjet organizatash që merren me të drejtat digjitale në Evropë.

Sipas tij, thjesht shtyrja e aksesit nuk trajton faktorë të tjerë si modeli i biznesit të platformave, dizajni që nxit përdorimin e vazhdueshëm dhe praktikat manipuluese me të cilat përdoruesit përballen pasi arrijnë kufirin e përcaktuar të moshës.

Mosha si tregues i vetëm i cenueshmërisë

Një nga kundërshtimet kryesore të De Brouwer lidhet me faktin se moshë trajtohet si faktori kryesor i cenueshmërisë.

“Faktori i vetëm i cenueshmërisë që merret në konsideratë është moshë e re. Por ka edhe shumë faktorë të tjerë”, u shpreh ai.

Sipas tij, EDRI synon të përfaqësojë edhe grupet e marginalizuara, zërat e të cilave, sipas tij, nuk dëgjohej gjithmonë në Bruksel.

Postimet e reja

BE vendos kufij për rrjetet sociale: Kush rrezikon të...

SEPTEMBER 26, 2026

Aksident tragjik në Fushë-Krujë, humb jetën 19-...

SEPTEMBER 26, 2026

Moti sot/ Temperaturat deri në 28°C, ja qytetet ...

SEPTEMBER 26, 2026

Zbulimi i çuditshëm në Arktik/ 65 kraterë të rinj...

SEPTEMBER 25, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 24, 2026

Dosja/ Biznesmeni Meqemeja i dha Ahmetajt 140 mijë euro! SPAK: Shpërblim për Inceneratorin e Fierit përmes shitjeve fiktive

Biznesmeni Sokol Meqemeja njihet si pronar i disa kompanive apo sipërmarrjeve. Përveç ‘Delvina Gas’ ai...

ALERT në Sloveni për VIPA Flips të Kosovës, kanë përmbajtje të alergjenësh. Produkti hiqet nga tregu

Kreditorët te dera, gjykata në kërkim të “Top Fruits” të Ejup Ahmetit dhe Marin Gjonajt: Paraqituni në gjyq

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Na ndiq

Kjo çështje bëhet veçanërisht e rëndësishme kur diskutohet verifikimi i moshës. Edhe pse mekanizmi synon të mbrojë fëmijët, kritikët argumentojnë se, në praktikë, mund të krijojë një situatë ku të gjithë përdoruesit duhet të provojnë moshën e tyre.

“Nëse vërtet duhet të dimë kush është i mitur për ta mbrojtur më mirë, atëherë duhet të dimë moshën e të gjithëve”, argumentoi De Brouwer.

Sipas tij, kjo mund të bëjë që telefonat inteligjentë dhe dokumentet e identitetit të kthehen në parakushte për aksesin në hapësirat online dhe, në një kuptim më të gjerë, për ushtrimin e disa të drejtave themelore.

Në këtë situatë mund të preken persona pa dokumente shtetërore identiteti, persona pa shtetësi, migrantë që nuk janë integruar plotësisht në sistemet kombëtare, por edhe njerëz që zgjedhin të mos përdorin telefonat inteligjentë.

Kush mund të mbetet i përjashtuar?

Debatit nuk lidhet vetëm me të rriturit. Kufizimet mund të ndikojnë edhe te disa prej të rinjve që synohen të mbrohen nga nisma, veçanërisht ata që mbështeten te interneti për të krijuar marrëdhënie shoqërore.

De Brouwer përmend të rinjtë me aftësi të kufizuara, të cilët mund të kenë më pak mundësi për ndërveprim fizik, të rinjtë që jetojnë në zona rurale dhe nuk kanë miq pranë, si dhe ata që nuk marrin mbështetjen e mjaftueshme nga prindërit.

Për këto grupe, interneti mund të shërbejë si një mënyrë për të gjetur njerëz me interesa, përvoja apo identitete të ngjashme.

“Numri i të rinjve që mund të humbasin mundësitë është shumë i madh”, tha ai.

Francesca Pisanu, zyrtare e lartë e politikave në Eurochild, një rrjet që fokusohet te të drejtat e fëmijëve, e ka mirëpritur në parim synimin e Aktit, por ka theksuar se çështja e aksesueshmërisë duhet të shqyrtohet me kujdes.

Sipas saj, rrjetet sociale dhe interneti në përgjithësi mund të jenë hapësira ku fëmijët dhe të rinjtë ndihen pjesë e shoqërisë. Në këto hapësira ata mund të gjejnë persona me identitete të ngjashme dhe të njihen me një diversitet më të madh.

Nga ana tjetër, Pisanu paralajmëron se diskriminimi që ekziston në botën reale mund të shfaqet edhe online. Për këtë arsye, sipas saj, masat mbrojtëse dhe ato që nxisin përfshirjen duhet të zbatohen paralelisht, në mënyrë që të mos krijojnë përplasje me njëra-tjetrën.

Ajo përmendi gjithashtu një studim të lidhur me Eurochild në Holandë, sipas të cilit fëmijët me aftësi të kufizuara ose me probleme të shëndetit mendor ishin ndër grupet që mbështesnin një ndalim. Kjo tregon se edhe grupet e marginalizuara mund të kenë qëndrime të ndryshme për mënyrën se si duhet të rregullohet përdorimi i rrjeteve sociale.

Përplasja me iniciativa të tjera

Për De Brouwer, shqetësimi shkon përtej vetë Aktit për Fëmijët dhe lidhet edhe me mënyrën se si kjo nismë mund të ndërveprojë me iniciativa të tjera evropiane.

Ai shpreh shqetësimin se Akti për Fëmijët mund të zbehë Aktin për Drejtësinë Digjitale (Digital Fairness Act – DFA), një nismë që synon të forcojë mbrojtjen e konsumatorëve në internet, pavarësisht nga shërbimi që përdorin.

Sipas tij, përqendrimi i tepërt te fëmijët mund të bëjë që të humbet mundësia për të përmirësuar mbrojtjen e të gjithë përdoruesve.

Ai argumenton se disa prej masave që parashikohen për të miturit mund të ishin të dobishme edhe për të rriturit. Mes shembujve përmenden edhe asistentët me inteligjencë artificiale dhe mënyra se si disa prej tyre mund të projektohen për të mbajtur përdoruesit sa më gjatë në platformë.

Debatit që mbetet i hapur

Në qendër të debatit është një pyetje më e gjerë: si të mbrohen fëmijët në internet pa krijuar njëkohësisht barriera të reja për njerëzit që varen nga hapësirat online për komunikim, përfshirje dhe pjesëmarrje shoqërore?

Parlamenti Evropian dhe Këshilli i BE-së duhet të përcaktojnë qëndrimet e tyre mbi Aktin për Fëmijët, ndërsa Komisioni Evropian duhet të shqyrtojë ndikimin e rregullave mbi të drejtat themelore deri më

Facebook

Instagram

YouTube

TikTok

31 gusht 2030.

Debati pritet të përqendrohet jo vetëm te mënyra se si mund të kufizohet ekspozimi i fëmijëve ndaj praktikave të dëmshme online, por edhe te mënyra se si mund të garantohet që masat e reja të mos krijojnë pengesa të panevojshme për grupet që e përdorin internetin si një mjet të rëndësishëm komunikimi, mbështetjeje dhe përfshirjeje.

BE rrjetet sociale

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A
Email: radarlajme@gmail.com
Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Horoskopi/ Parashikimi i yjeve për ditën e sotme, 24 Shtator 2026

Njohje të reja për beqarët, mundësi fitimi dhe sfida në punë, çfarë thonë yjet për ju sot

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.